



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN & KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Tryeza për Kapitullin 23 – Roli aktiv i Shoqërisë Civile në Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike në kuadër të Kriterit Politik

E hënë, 22 janar 2024, 11:00 – 13:00

Salla Gold, Grand Hotel, Tiranë

Ministria e Drejtësisë dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në takimin e radhës së Tryezës së Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 23 në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian dhe Konventës Kombëtare për Integrimin Europian.

Tryeza për Kapitullin 23 është një element i rëndësishëm për të mundësuar përfshirjen e aktorëve jo-shtetërorë në procesin e negociatave jo vetëm për ti informuar për procesin, por mbi të gjitha që ata të kenë një rol aktiv në dhënien e sugjerimeve dhe komenteve mbi kuadrin ligjor dhe politikat e ndërmarra, si dhe për të monitoruar këtë proces në të gjitha fazat e tij.

Ky takim i Tryezës për Kapitullin 23 do të ketë një vëmendje të veçantë në diskutimin mbi rolin aktiv që mund dhe duhet të luajnë aktorët e shoqërisë civile për **Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike** si gjatë procesit të miratimit, por mbi të gjitha për monitorimin e masave dhe prioritetëve të parashikuara në Udhërrëfyes, duke mbajtur në konsideratë afatet e vendosura dhe nevojën për koordinim dhe bashkëpunim mes aktorëve shtetërorë dhe atyre jo shtetërorë.

Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike është përgatitur nga Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Europian (GNPIE) dhe është i një rëndësie të veçantë për vazhdimësinë e procesit të negociatave për Grupimin 1 – Themeloret. Fushat që ky udhërrëfyes përfshin janë: I. Procesi zgjedhor, II. Funksionimi i Kuvendit dhe III. Roli i shoqërisë civile.

Fokus i veçantë diskutimit do të jetë në përfshirjen aktive të aktorëve të shoqërisë civile dhe mënyrat e përfshirjes së tyre mbi procesin vendimmarrës dhe monitorimin e politikave të parashikuara për tu miratuar dhe zbatuar në kuadër të udhërrëfyesit, me qëllimin e një politikëbërjeje sa më transparente, gjithëpërfshirëse si dhe për të synuar rritjen e dialogut mes palëve dhe për të pasur një shoqëri civile që është një aktor i genësishëm me kontribut të prekshëm në kuadër të procesit të negociatave me BE-në.

Ju ftojmë të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: info@em-al.org
Mirëpresim përfshirjen dhe kontributin tuaj në këtë aktivitet!

* Tryeza e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 23 organizohet në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian".

*Ky sesion konsultues zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN & KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

**Tryeza për Kapitullin 23 – Roli aktiv i Shoqërisë Civile në Udhërrëfyesin për
Funksionimin e Institucioneve Demokratike në kuadër të Kriterit Politik**

E hënë, 22 janar 2024, 11:00 – 13:00

Salla Gold, Grand Hotel, Tiranë

10:30 – 11:00 REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE DHE KAFE E MIRËSEARCHJES

**11:00 – 11:30 HAPJA E TAKIMIT DHE PREZANTIMI I UDHËRRËFYESIT PËR
FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE**

Elona Bano, Drejtore e Integritit dhe Negociatave, Ministria e Drejtësisë

**11:30 – 12:15 UDHËRRËFYESI PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE
DEMOKRATIKE – SI MUND TË PËRFSHIHEN AKTORËT E SHOQËRISË
CIVILE NË MËNYRË AKTIVE DHE KONKRETE**

- Roli i Platformës së Partneritetit për Integritin Europian për Kapitullin 23 në informimin dhe përfshirjen aktive të aktorëve jo-shtetërorë

- Roli i shoqërisë civile dhe mangësitë apo problematikat që ato hasin për tu përfshirë aktivisht në proces në Shqipëri

- Mësime të nxjerra nga eksperiencia e vendeve të rajonit - raste suksesi të përfshirjes së shoqërisë civile në procesin negociues

Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri

Ndërhyrje dhe komente nga ekspertë të shoqërisë civile dhe procesit të negociatave

12:15 – 13:00 DISKUTIME ME ANËTARËT E TRYEZËS PËR KAPITULLIN 23

13:00 MBYLLJA E AKTIVITETIT

** Tryeza e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 23 organizohet në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integritin Europian".*

**Ky sesion konsultues zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*